

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë kundërshton projektligjin për pagat e magjistratëve: Nuk është reflektuar vendimi i Kushtetueses - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/votimi-nga-komisioni-i-ligjeve-i-ndryshimeve-per-pagat-e-magjistrate-ve-reagon-gjykata-e-larte/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:23:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:22:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2fb8f2ba701a137641f5e57d53b36450ef3b321ea8d924034a88b2047a2d661c
TEKSTI	30806ec9aa22e0c5b95d395bb14b98c36504f87bd84f57e1a5559851a5b1dc2a
PAMJA	3a95dbcf826e98a5e7a12023bcccd713f6d495c16edc4bc65baf91b5fc128807

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b49b4855669e047ea78e8f57ccf178e557bec8f376439c76c6203750ba8b9d15
E MËPARSHMJA	088ee16f4e8411a60a52956d3d7a6204b1bceeac69714122dec103c76ee3a9f0
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b49b4855669e047ea78e8f57ccf178e557bec8f376439c76c6203750ba8b9d15>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Rexhep Selimi Mbretëri e Bashkuar Jakup Krasniqi Noah Woods

AKTUALITET

Gjykata e Lartë kundërshton projektligjin për pagat e magjistratëve: Nuk është reflektuar vendimi i Kushtetueses

16 Shtator 2026 | 15:22

Gjykata e Lartë i kërkon Kuvendit të mos miratojë projektligjin për pagat e magjistratëve në seancën plenare të 17 shtatorit, duke kundërshtuar mënyrën se si është zhvilluar procedura parlamentare dhe duke argumentuar se në tekstin e propozuar nuk është reflektuar në përmbajtje arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese.

Në një reagim publik, Gjykata e Lartë shprehet se konsultimi me përfaqësuesit e gjyqësorit nuk ka qenë efektiv dhe se shqetësimet e ngritura prej tyre nuk kanë gjetur refleksim në projektligjin që pritet të votohet.

Sipas Gjykatës së Lartë, përfaqësuesit e gjyqësorit janë njoftuar më pak se dy orë përpara për t'u paraqitur në Komisionin për Çështjet Ligjore. Pavarësisht afatit të shkurtër, ata morën pjesë në dëgjese, duke vlerësuar rëndësinë e situatës dhe përgjegjësinë institucionale.

Gjykata thekson se kishte përcjellë përmes Këshillit të Lartë Gjyqësor në Kuvend një opinion të plotë juridik dhe kushtetues, ku ngriheshin disa çështje që prekin sistemin gjyqësor në tërësi. Mes tyre përmenden paga referuese dhe raporti i saj me koeficientin 0.38 të pagës së Presidentit të Republikës, efektet pas datës 31 korrik 2026, trajtimi i pagave të prapambetura dhe ruajtja e hierarkisë së pagave brenda sistemit gjyqësor.

Gjykata kundërshton gjithashtu mënyrën e zhvillimit të dëgjesës në Komisionin për Çështjet Ligjore. Sipas saj, përfaqësuesve të gjyqësorit nuk iu vunë në dispozicion të gjitha amendamentet që ndryshonin projektligjin dhe as informacioni i plotë mbi opinionin financiar të Qeverisë.

"Dëgjesa nuk solli asnjë refleksim të dukshëm mbi argumentet e paraqitura", thuhet në reagimin e Gjykatës së Lartë.

Sipas institucionit, konsultimi me pushtetin gjyqësor nuk duhet të mbetet një procedurë formale, por duhet të pasqyrojë shqyrtimin real të argumenteve të paraqitura.

Në reagimin e saj, Gjykata e Lartë i referohet edhe vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, duke theksuar se ai nuk duhet vetëm të citohet në mënyrë formale, por arsyetimi i tij kushtetues duhet të reflektohet në përmbajtjen e ndërhyrjes së re ligjore.

"Nga një komision parlamentar që shqyrton kushtetutshmërinë dhe cilësinë juridike të legjisllacionit pritet jo thjesht të citojë një vendim të Gjykatës Kushtetuese, por të analizojë

LAJMI I FUNDIT

18:35 **Bajraktari: Vendimi i Speciales skandaloz, skena politike në Kosovë të bëhet bashkë**

18:31 **Të dhënat e qindra klientëve të evropianë të një banke dixhitale bien në duart e hakerëve**

18:31 **"Do t'i biem pishmanit, por do jetë vonë", momenti kur Rexhep Selimi i lutej Jakup Krasniqit kundër Gjykatës Speciale (VIDEO)**

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

18:15 **Zhduket 3-vjeçari nga këndi i lojërave në Angli, mbi 1 000 persona mobilizohen në kërkime për gjetjen e tij**

18:07 **Planeti nën sulm nga dy stuhi diellore: Cilat zona do të preken?**

18:01 **Shembet miniera e arit në Sudan, 82 të vdekur dhe 50 të plagosur**

TESTIM

dhe të reflektojë arsyetimin e tij në normën që propozon për votim”, thuhet në deklaratë.

Në përfundim, Gjykata e Lartë i kërkon Kuvendit të mos e kalojë për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të 17 shtatorit projektligjin në formën që ndodhet aktualisht.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET

Plagosje me armë zjarri në Durrës

Një i ri është plagosur me armë zjarri pak momente më parë në lagjen nr. 1 të Durrësit, në zonën e Vollgës. Pas të shtënave,...

18:00 | 16/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Pagat e magjistratëve, Prokuroria e Përgjithshme: Diferenca të pajustificuara dhe jo harmonike

Prokuroria e Përgjithshme këtë të mërkurë i përcolli nëpërmjet një shkrese zyrtare, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, qëndrimin e saj mbi projektligjin për pagat e...

13:26 | 16/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Rritja e çmimit të naftës, ministrja Ibrahimaj njofton ringritjen e Bordit të Transparencës

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, njoftoi pas mbledhjes së qeverisë këtë të mërkurë vendimin për riaktivizimin e Bordit të Transparencës për çmimet e...

12:45 | 16/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: